



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:247049

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05684811

KE.nr.412/23

PROCESVERBAL I SEANCËS PËRGADITORE

I përpiluar më datë 15.05.2024 në GJYKATËN KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë,
Departamenti për Çështje Ekonomike

Gjyqtari:
Arbër Rexha

Zyrtarja ligjore
Rreze Doli

Paditësi: TEB BANK

E paditura: 1.Burim SHPK, 2.L.L.

Lënda e kontestit: Borxh.

Filloi në 09:10.
Seanca është publike

Gjyqtari e hap seancën, publikon lëndën e shqyrtimit dhe përbërjen e gjykatës.

Palët pa vërejtje.

Konstatohet se prezent janë:

Për paditësin: Sipas autorizimit G.N., zyrtar ligjor pranë paditësit identitetin e të cilit Gjykata e vërtetoj përmes letërnjoftimit me nr.personal:...

Për të paditurën e parë: F.L., pronar dhe person i autorizuar i Burimi SHPK, identitetin e të cilit Gjykata e vërtetoj përmes letërnjoftimit me nr personal:....

Për të paditurën e dytë: L.L., personalisht identitetin e të cilës Gjykata e vërtetoj përmes letërnjoftimit me nr.personal:

Meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e seancës se sotme, Gjykata merr këtë:

A K T V E N D I M

Seanca e sotme përgatitore mbahet.

Gjykata konstaton se lidhur me këtë çështje është vendosur sipas Aktgjykimit I.EK.nr. 693/18, i datës 04.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, ndërsa me Aktvendimin e Dhomave të Shkallës Dytë të Gjykatës Komerciale K.DH.SH.II.nr.1501/22 të datës 23.03.2023 është aprovuar ankesa e palëve dhe lënda është kthyer në rivendosje.

Ftohet përfaqësuesi i paditësit që të deklaroher.

Përfaqësuesi i paditësit deklaron: pas konsultimeve me palët e paditura përfaqësuesi i paditësit është dakorduar që në këtë çështje juridike të lidhet ujdj gjyqësore me të cilën ujdj të detyrohet vetëm e paditura e dytë Lumnije Krasniqi për kthimin e borxhit, andaj Gjykatës i propozon që kjo çështje të mbyllet sipas ujdisë gjyqësore si ne vijim

PAJTIM GJYQËSOR

DETYROHET L.L. nga Gjilani rr. “Pajazit Ahmeti” me nr. personal:.... që në emër të kthimit të borxhit mbi bazën e marrëveshjeve të kredisë të ia paguajë paditësit shumën e përgjithshme prej 17,645.25 euro, dhe atë në këste mujore në lartësi prej 200.00 euro për çdo muaj duke filluar nga muaji qershor 2024 e deri në pagesën definitive, meqë rast pagesa do të bëhet çdo muaj deri me dt.15 të muajit vijues, në xhirollogari të paditësit.

Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Përfaqësuesi i të paditurit të parë pajtohet me lidhjen e këtij pajtimi gjyqësor.

Përfaqësuesi i të paditurit dytë pajtohet me lidhjen e këtij pajtimi gjyqësor.

Gjykata pasi që, analizoj objektin e këtij pajtimi gjyqësor në kuptim nenit 3 të LPK-së, konstatoj që në këtë çështje ka të bëjë me objekt kontesti për të cilën palët mund të disponojnë lirshëm me kërkesat e tyre. Andaj, në bazë të nenit 414 të LPK-së, Gjykata merr këtë:

A K T V E N D I M

LEJOHET lidhja e pajtimit gjyqësor në këtë çështje juridike.

Ky pajtim ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

Lënda çregjistrohet nga regjistri i lëndëve me nr. ‘KE’.

Palët deklarojnë që nuk kanë propozime tjera.

Përfundoi në orën 09:50.

Palët prezente e lexuan dhe e nënshkruan procesverbalin pa vërejtje.

Numri i lëndës: 2019:247049
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05684811

Përfaqësuesi i paditësit

I Padituri parë Burimi SHPK

E paditura L.L.

Vërtetojnë:

Zyrtarja Ligjore

Gjyqtari